

Informacion Kryesor Për Investitorin

Ky dokument paraqet informacionin kryesor për investitorin në lidhje me Fondin, i cili nuk përbën një informacion marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe rreziqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo.

Kuatat e Fondit nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave. Investimi në fondin WVP Top Invest nuk është i garantuar, fondi nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetit të vlerës neto të aseteve dhe rreziku i humbjes së principalit përballohet nga investitori.

FONDI I INVESTIMIT ME PJESËMARRJE TË HAPUR WVP TOP INVEST - Sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, i cili administrohet nga WVP Fund Management Tirana sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Investimit.

Objektivat dhe Politika e Investimit*

Objektivi

Objektivi i Fondit është që t'i japë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe të likuiditetit të nevojshëm. Fondi për krahasim të performancës dhe ecurisë së investimeve, i referohet një benchmark-u të veçantë të krijuar për nevojat e grupacionit.

Benchmark i WVP Top Invest

WVP Fund Management ka vendosur Benchmark-un për WVP Top Invest të jetë i kompozuar në 30 % Dow Jones Industrial Average Index dhe 70 % Stoxx Europe 50 Index. Sipërmarrja nuk ka objektiv të gjurmimit të ndonjë indeksi.

Kategoritë kryesore të instrumenteve financiarë

Fondi WVP Top Invest do të investojë kryesisht në letra me vlerë, aksione të kompanive të mëdha të listuara në tregjet më të zhvilluara dhe më të rregulluara të botës. Në fokus të politikës investuese të fondit do të jenë kompanitë e mëdha – "Large Caps", të cilat janë udhëheqës në industritë e tyre dhe kanë histori të vazhdueshme rritëse të pagesës së dividendit kundrejt investitorëve.

Në procesin e investimit kujdes i madh do t'i dedikohet minimizimit të rreziqeve, të cilat mund të hasen tek këto lloj investimesh. Në procesin e administrimit të mjeteve të Shoqërisë do të zbatohet përvoja (eksperienca) shumëvjeçare (mbi 30 vite) e WVP Group, kryesisht politika investuese e investimit të fondit të mbyllur të investimeve WVP Invest në Austri.

Shitja e kuotave

Investitori mund të kërkojë shitjen e kuotave në çdo kohë, dhe shlyerja e tyre bëhet brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nga data e mbërritjes së kërkesës.

Të ardhurat nga investimi

Të ardhurat e fondit nuk shpërndahen por ri-investohen.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta



Shpjegim narrativ i treguesit dhe i kufizimeve kryesore të tij:

- Të dhënat historike nuk mund të përdoren si indikatorë të qëndrueshëm për të përcaktuar të ardhmen;
- Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës;
- Kategoria më e ulët nuk nënkupton mungesën e plotë të riskut;
- Profili i parashikuar i rrezikut të fondit do të jetë i përkrahshëm nga kategorisë 6, duke patur parasysh faktin që shumica e aseteve të fondit do të investohen në aksione të cilat tregtohen në bursa të rregulluara ndërkombëtare ku ekziston rreziku i luanshmërisë së çmimeve.

Faktorët që mund të ndikojnë në performancën e fondit

Performanca e Fondit dhe rrjedhimisht edhe vlera e investimit mund të luhet në varësi të kushteve të tregut. Luhatja e çmimit të instrumenteve financiare në të cilat fondi investon është faktori kryesor, i cili ndikon në performancën e fondit. Rritja e çmimit të tyre ndikon pozitivisht dhe anasjelltas.

Rreziku nga kurset e këmbimit paraqet një formë të rrezikut i cili paraqitet gjatë ndryshimit të çmimit të një valute në raport me tjetrën. Fondi në portofolin e vet zotëron tituj të vlerësuar në valuta të ndryshme dhe ndryshimet e mundshme të këtyre valutave në raport me valutën e vendit mund të çojnë deri tek rritja ose zvogëlimi i vlerës së kuotave. Këtë rrezik Shoqëria do ta reduktojë me shpërndarjen e portofolit në valuta të huaja të ndryshme, duke tentuar të uli lëvizjet e mëdha të valutave botërore.

Periudha Kohore e Investimit

Periudha kohore e investimit rekomandohet të jetë të paktën 10 vite, në mënyrë që të rriten mundësitë për një kthim optimal nga investimi.

Fondi nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një mënyrë investimi afatmesëm dhe afatgjatë me qëllim sigurimin e një kthimi të kënaqshëm dhe diversifikim të aseteve. Qëndrimi shumë i shkurtër në fond mund të rezultojë në një kthim të pakënaqshëm.

**Për më tepër informacion mbi objektivat e investimit jeni të lutur t'i referoheni prospektit të Fondit WVP Top Invest.*

Domethënia e treguesit sintetik dhe kufizimet e tij

Treguesi sintetik i rrezikut ka për qëllim t'i japë investitorit një ide mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen. Luhatshmëria e tregjeve financiare ndikon në performancën e fondit dhe kjo mund të sjellë ndryshimin e këtij treguesi në të ardhmen. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.

Pse Fondi WVP TOP INVEST është në këtë kategori rreziku?

Fondi investon kryesisht në letra me vlerë/aksione me një profil risku të lartë. Luhatshmëria e çmimeve është një nga tiparet kryesore që kanë aksionet në bursat me likuiditet të lartë, dhe kjo rezultojnë që edhe risku të jetë në një nivel më të lartë.

Rreziqe me rëndësi materiale të cilat nuk mbulohen tërësisht nga treguesi sintetik:

Rreziku i tregut: Është rreziku i luhatshmërisë të çmimit të titujve në treg. Ulja e çmimit të titujve mund të sjellë uljen e vlerës së portofolit të Fondit si dhe e kundërta. Me qëllim mbrojtjen nga rreziku i tregut dhe minimizimin e tij, Shoqëria do të operojë nëpërmjet diversifikimit të portofolit, në përputhje me parimin e shpërndarjes së rrezikut.

Rreziku i Kurseve të Këmbimit

Rreziku nga kurset e këmbimit paraqet një formë të rrezikut i cili paraqitet gjatë ndryshimit të çmimit të një valute në raport me tjetrën. Fondi në portofolin e vet zotëron tituj të vlerësuar në valuta të ndryshme dhe ndryshimet e mundshme të këtyre valutave në raport me valutën e vendit mund të çojnë deri tek rritja ose zvogëlimi i vlerës së kuotave. Këtë rrezik Shoqëria do ta reduktojë me shpërndarjen e portofolit në valuta të huaja të ndryshme, duke tentuar të uli lëvizjet e mëdha të valutave botërore.

KUJDES: Fondi WVP Top Invest është në LEKË dhe çdo ndryshim valutor në bazë ditore mund të çojë deri tek zvogëlimi ose rritja e vlerës së kuotave.

Kursi valutor në LEKË merret nga kursi i Bankës së Shqipërisë

Rreziku i likuiditetit: Rreziku që një aset të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut. Për të menaxhuar këtë rrezik, fondi do të investojë në instrumente financiare të listuara dhe të tregtuara në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, të cilat konsiderohen si aktive (asete financiare) likuide me cilësi të lartë.

Rreziku operacional: Ky është rreziku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerezore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të


dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregëtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

Komisionet dhe tarifat e SIK

Kostot që paguajnë mbajtësit e kuotave shkojnë për të mbuluar shpenzimet e administrimit të fondit WVP Top Invest. Këto pagesa reduktojnë rritjen potenciale të investimit tuaj. Pagesat mund të jenë subjekt ndryshimi. Tarifa e hyrjes është kosto që investitori e paguan gjatë investimit të aseteve në Fond, më qëllim të blerjes së kuotave dhe e njëjta vlerë i zbritet nga shuma e investimit të parë. Tarifa e hyrjes do të përcaktohet sipas shkallës të paraqitur në tabelën në vijim:

Komisione/tarifa të njëherëshme përpara ose pas investimit		
Komisioni/tarifa e hyrjes	Shuma (LEK)	Tarifa e hyrjes (%)
	Deri 2.035.000	5%
	2.035.001 - 3.400.000	4,5%
	3.400.001 - 6.800.000	4%
	6.800.001 - 13.600.000	3,5%
	13.600.001 – 34.000.000	3%
	34.000.001- 68.000.000	2,5%
	68.000.001- 136.000.000	2%
	136.000.001-340.000.000	1,5%
	Mbi 340.000.000	1%
Në lidhje me “komisionet apo tarifat e hyrjes dhe daljes” duhet të bëhet e qartë se shifrat e paraqitura janë shifra maksimale, pasi në disa raste investitori mund të paguajë më pak, për këtë fakt investitori mund të informohet nga këshilltari i tij i investimit		
Komisioni/tarifa e largimit	0%	
Komisione/tarifa të vazhdueshme që mbahen nga asetet e Fondit në një vit		
Komisioni vjetor i administrimit	2%	
Komisione dhe tarifa të tjera të vazhdueshme:	Shifra e tarifave të vazhdueshme do të mbështetet në shpenzimet e fundit të vitit, e cila mund të ndryshojë nga viti në vit. Kostot totale nuk do të kalojnë më shumë se 3% në vit të vlerës neto të aseteve të fondit.	
Tarifat dhe kostot që i paguhen Depozitarit;	Në të nuk përfshihen:	
Kostot për auditim vjetor;	-Kostot e transaksioneve të portofolit,	
Tarifat rregullatore;	duke përfshirë rastin e komisioneve dhe tarifave për hyrje dhe dalje të	
Kostot, komisionet ose shpërblimet për shitblerjen e Aseteve;	paguara nga SIK, kur blihen dhe shiten	
Kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospekt;	kuota të SIK, të tjera.	
Kostot e e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifat postare për raportet vjetore për mbajtësit e kuotave.		

Për më tepër informacion rreth tarifave dhe kostove, jeni të lutur t'i referoheni seksionit 10 të prospektit të Fondit WVP Top Invest, të cilin mund ta gjeni në faqen tonë: www.wvpfunds.al



Performanca historike e Fondit:

- Fondi ka filluar aktivitetin më 29 Mars 2018
- Gjatë vitit 2024 fondi ka rezultuar me një normë kthimi neto prej 6.28% dhe, me një normë kthimi neto 15.76% që nga fillimi i aktivitetit të tij deri më 31 Dhjetor 2024.
- Performanca përfaqëson normën e kthimit neto mbasi janë zbritur të gjitha kostot dhe tarifat që i mbahen fondit.
- Performanca e kaluar është një udhërrëfyes i kufizuar për performancën e ardhshme.
- Performanca e kaluar është e llogaritur në monedhën Lekë.

Informacion Praktik

- Banka Depozitare e Fondit është First Investment Bank sh.a
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecursisë së Fondit mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.wvpfunds.al, si dhe pranë çdo dege të WVP Fund Management Tirana Sh.A.
- Çmimi i kuotës së fondit publikohet çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.wvpfunds.al, ku mund të gjeni informacion më të detajuar mbi fondin.
- Ju lutemi vini re: legjislacioni tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë aplikohet mbi të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në fond.
- WVP Fund Management sh.a. mban përgjegjësi ligjore vetëm në bazë të atyre që thuhet në këtë dokument, të cilat janë keqorientuese, të pasakta ose jo në përputhje me pjesët përkatëse të prospektit të SIK.

Ky fond është i licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregullohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. WVP Fund Management Tirana sh.a është e licencuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregullohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën 02.09.2025